



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/145
Datë: 07.06.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në Marrëveshjen Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues dhe Koordinues për shqyrtimin e progresit të zbatimit të masave të Planit të Zbatimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, i aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023, i realizuar përmes përkrahjes buxhetore brenda IPA 2023, në përbërje të përfaqësuesve, si në vijim:
 - 1.1. Getoar Mjeku, Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë, kryesues;
 - 1.2. Milaim Aliu, Përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Zëvendëskryesues;
 - 1.3. Hidajete Zhuri, Përfaqësuese nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtare;
 - 1.4. Ahmet Ismaili, nga Fondi i Kosovës për Eficiençën e Energjisë, anëtar;
 - 1.5. Florim Canolli, Drejtor, Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim/ZKM, anëtar.
2. Me qëllim të koordinimit rreth zbatimit të detyrave nga pika 1. e këtij Vendimi dhe për të qenë pjesë e këtij Komiteti në rolin e vëzhguesit ftohen për të dërguar përfaqësuesit e tyre:
 - 2.1. Zyra e BE-së në Kosovë;
 - 2.2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë;
 - 2.3. Fondi i Kosovës për Garancitë Kreditore.
3. Në takime mund të ftohen edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të nivelit qendror apo lokal, sipas nevojës gjithashtu edhe përfaqësues të Kabinetit të Zëvendëskryeministrit të Parë, përfaqësues të ME-së, MFPT-së, MMPHI-së, MAPL-së, apo institucioneve tjera. Kryesuesi ka autorizimin e plotë që të përcaktoj institucionet e nevojshme për të qenë bashkëpunuese për të siguruar zbatimin e qëllimit të këtij Vendimi.
4. Komiteti ka për detyrë shqyrtimin periodik të zbatimit të masave të Planit të Zbatimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, të siguruara nga përkrahja buxhetore të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2023, si dhe konsultimin dhe koordinimin e vazhdueshëm me BE-në për realizimin e detyrimeve të dakorduara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së siç përcaktohen në Marrëveshje dhe Shkresën Njoftuese të BE për disbursim të datës 13 mars 2023.

5. Komiteti bën monitorimin e zbatimit të masave dhe kërkesave të tjera të përcaktuara në Marrëveshjen Financiare përmes stafit të Ministrisë së Ekonomisë, të cilët shërbejnë si Sekretari e Komitetit. Konstatimet e tij i shpreh në procesverbalin e mbledhjes.
6. Komiteti do të hartojë një format të standardizuar të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e zbatimit të masave, duke përfshirë edhe një seksion të veçantë për sfidat dhe rekomandimet konkrete për adresimin e tyre.
7. Komiteti do të pranojë në baza mujore raportin nga pika 6. nga secili institucion përgjegjës dhe do ta ndajë atë në version të konsoliduar me anëtarët nga pika 1. dhe 2. e Vendimit.
8. Komiteti takohet dhe shqyrton raportin e progresit, së paku njëherë në çdo dy (2) muaj, apo edhe sipas nevojës, kur mbledhja ftohet nga kryesuesi apo me kërkesën e dy anëtarëve nga pika 1. dhe 2. e Vendimit.
9. Komiteti do të përgatis raport të rregullt progresi në baza së paku dy (2) mujore dhe një raport përfundimtar të cilat duhet të përmbajnë përshkrimin e saktë të masave të zbatuara si dhe kërkesat të tjera sipas Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2023. Raporti i tillë i dërgohet Zyrës së Kryeministrit si dhe Zyrës së BE-së.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë